

LIGJI NR. 08/L-145**PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E INTEGRUAR TË NDOTJES****Kuvendi i Republikës së Kosovës:**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E INTEGRUAR TË NDOTJES**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1
Qëllimi**

1. Ky ligj ka për qëllim të përcaktoj kompetencat, procedurat dhe përgjegjësitë e institucioneve për pajisjen me leje të impianteve, mbikëqyrjen inspektuese, si dhe detyrimet e operatoreve, lidhur me parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes nga veprimtaritë e ndryshme industriale në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë për mbrojtjen e mjedisit.
2. Ky ligj është pjesërisht në përputhshmëri me Direktivën 2010/75/BE për emisionet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes).

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Ky ligj zbatohet ndaj të gjithë personave fizik dhe juridik, dhe të gjitha autoriteteve publike dhe private, veprimtaritë e ndryshme industriale, aktiviteti i të cilave në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë shkakton ndotjen e ajrit, ujit, tokës dhe gjenerimin e mbeturinave.
2. Ky ligj nuk zbatohet për veprimtaritë hulumtuese, zhvilluese ose testimin e produkteve të reja dhe proceseve.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Substancë** - nënkupton çdo element kimik dhe bashkëdyzimet e tij, me përjashtim të substancave radioaktive dhe organizmat e modifikuar gjenetikisht;

1.2. **Ndotja** - nënkupton shkarkimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë si rezultat i veprimtarisë njerëzore, të substancave, vibracioneve, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë, ose tokë, të cilat mund të jenë të dëmshme për shëndetin e njeriut ose mjedisin e që rezultojnë në dëmtimin e pronës materiale, përkeqësimin ose ndërhyrjen në ambientet dhe përdorimet e tjera legjitime të mjedisit;

1.3. **Impiant** - nënkupton njësinë statike teknike ku kryhen një ose më shumë veprimtari të përcaktuara në Shtojcën 1 dhe çfarëdo veprimtari tjera ndërlidhëse të drejtpërdrejta të cilat kanë lidhje teknike me veprimtaritë e kryera në atë vend dhe të cilat mund të kenë ndikim në emisione dhe ndotje;

1.4. **Impianti ekzistues** - nënkupton impiantin që operon para hyrjes në fuqi të këtij ligji;

1.5. **Impiant i ri** - nënkupton çfarëdo impianti tjetër përveç impiantit ekzistues;

1.6. **Emision** - nënkupton shkarkimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të substancave, vibracioneve, nxehtësisë ose zhurmës nga burimet individuale ose ato shpërndarëse të një impianti në ajër, ujë ose tokë;

1.7. **Vlera kufitare e emisionit** - nënkupton sasinë e shprehur në kushtet e parametrave të caktuar, përqendrimit dhe/ose niveli i emisioneve, i cili nuk mund të tejkalohet gjatë një ose më shumë afateve kohore;

1.8. **Standardi i cilësisë së mjedisit** - nënkupton tërësinë e kërkesave të cilat mjedisi ose një pjesë e caktuar e tij duhet t'i plotësoj në kohën e caktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi;

1.9. **Leja Mjedisore e Integruar (këtu e tutje Leja)** - nënkupton autorizimin me shkrim që lejon funksionimin e plotë ose të pjesshëm të impiantit të përcaktuar në Shtojcën 1 të këtij ligji;

1.10. **Rregullat e përgjithshme detyruese** - nënkupton vlerat kufitare të emisioneve ose kushtet e tjera që vendosen me qëllim për të përcaktuar kushtet e lejes;

1.11. **Ndryshimi thelbësor** - nënkupton një ndryshim të operimit të një impianti që mund të ketë ndikime të dukshme negative në shëndetin e njeriut dhe mjedis;

1.12. **Ndryshim jo thelbësor** - nënkupton çdo ndryshim në karakteristikat e operimit, ose në kapacitetin e impiantit i cili pa u konsideruar si thelbësor mund të ketë efekt në siguri, shëndet ose mjedis;

1.13. **Teknikat më të mira në dispozicion (TMD)** - nënkupton fazën më efektive dhe të avancuar në zhvillimin e veprimtarive dhe metodave të tyre të operimit që tregojnë përshtatshmërinë praktike të teknikave të posaçme për të siguruar bazat e vlerave kufitare të emisioneve dhe kushteve të tjera të lejes të caktuara për të parandaluar edhe ku kjo nuk është e mundur për të zvogëluar emisionet dhe ndikimet në mjedis;

1.14. **Teknikat** - nënkupton teknologjinë e përdorur dhe mënyrën në të cilën është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur, operuar dhe montuar impianti;

1.15. **Teknikat në dispozicion** - nënkupton ato teknika të cilat janë zhvilluar në një shkallë që lejon zbatimin në sektorët përkatës të industrisë në kushtet të përshtatshme ekonomike dhe teknike duke marrë parasysh koston dhe përparësitë, pavarësisht nëse teknikat përdoren apo prodhohen në Republikën e Kosovës për aq kohë sa ato të jenë të arritshme në mënyrë të arsyeshme për operatorin;

1.16. **Teknika më e mirë** - nënkupton efektin në arritjen e një niveli të lartë të përgjithshëm të mbrojtjes së mjedisit në tërësi;

1.17. **Dokumenti i referimit të TMD-së** - nënkupton një dokument që rezulton nga shkëmbimi i informatave për veprimtaritë e caktuara dhe që përshkruan në veçanti teknikat e aplikueshme, emisionet aktuale dhe nivelet e konsumit, teknikat e konsideruara për përcaktimin e TMD-ve si dhe konkluzionet e TMD-së dhe çdo teknikë

të re duke marr parasysh në veçanti kriteret e përcaktuara në Shtojcën 3 të këtij ligji;

1.18. **Konkluzionet e TMD-së** - nënkupton dokumentin që përmban pjesët e dokumentit të referimit të TMD-së që përcaktojnë konkluzionet mbi TMD –të, përshkrimin e tyre, informatat për të vlerësuar zbatueshmërinë e tyre, nivelet e emisioneve që ndërlidhen me TMD-të, monitorimin, nivelet e ndërlidhura me konsumin dhe nëse është e nevojshme masat rehabilituese të lokacionit përkatës;

1.19. **Vlerat kufitare të emisioneve të ndërlidhura me TMD-në** - nënkupton një varg të niveleve të emisioneve të marra në kushte normale të operimit duke përdorur TMD -të ose një kombinim të TMD-ve siç përshkruhet në konkluzionet e TMD-së e dhënë si një mesatare gjatë një periudhe të caktuar kohore sipas kushteve të përcaktuara të referimit;

1.20. **Teknikat e reja** - nënkupton një teknikë të re për një veprimtari industriale që nëse zhvillohet në mënyrë komerciale mund të ofroj nivel më të lartë të mbrojtjes së mjedisit ose të paktën të njëjtin nivel të mbrojtjes së mjedisit dhe kursime më të larta të kostos se sa teknikat ekzistuese në dispozicion;

1.21. **Operatori** - nënkupton çdo person fizik ose juridik që operon ose kontrollon në tërësi një pjesë të impiantit, impiantet me djegie, impiantet për djegien e mbeturinave ose impiantet e bashkë-djegies së mbeturinave;

1.22. **Publiku** - nënkupton një ose më shumë persona juridik ose fizik, në përputhje me legjislacionin ose praktikën vendore, grupet, shoqatat ose organizatat;

1.23. **Pala e interesuar** - nënkupton një apo më shumë persona fizik ose juridik të prekur apo të ndikuar ose kanë interes në vendimmarrjen lidhur me lëshimin e lejes dhe kushteve të lejes;

1.24. **Substancat e rrezikshme** - nënkupton substancat ose përzierjet që kanë një ose më shumë veti të rrezikshme;

1.25. **Raporti bazë** - nënkupton gjendjen e dheut dhe ujërave nëntokësore nga substancat e rrezikshme;

1.26. **Ujërat nëntokësorë** - nënkupton të gjitha ujërat që janë nën nivelin e tokës në zonën e saturacionit dhe në kontakt me token ose dherat;

1.27. **Dheu** - nënkupton shtresën e sipërme të korës së tokës e cila gjendet ndërmjet bazës dhe sipërfaqes. Dheu përbëhet prej grimcave minerale, materieve organike, ujit, ajrit dhe organizmave të gjalla;

1.28. **Shpezët** - nënkupton llojet e shpezëve që mbahen të mbyllur për mbarësim, prodhimin e mishit ose vezëve, për konsum ose për ristrukturimin e furnizimeve të gjahut;

1.29. **Lëndë djegëse** - nënkupton çdo material në gjendje të ngurtë, të lëngshëm ose të gaztë që digjet;

1.30. **Implant për djegie** - nënkupton çdo pajisje teknike në të cilin oksidohen lëndët djegëse në mënyrë që të përdoret nxehësia e gjeneruar;

1.31. **Oxhak** - nënkupton një strukturë që përmban një ose më shumë shkarkues të cilët mundësojnë kalimin e gazrave me qëllim të shkarkimit të tyre në ajër;

1.32. **Orari i operimit** - nënkupton kohën e shprehur në orë, gjatë së cilës impianti

operon në tërësi ose në pjesë dhe shkarkon emisione në ajër, me përjashtim të periudhës së lëshimit dhe ndaljes së impiantit;

1.33. Shkalla e desulfurizimit - nënkupton proporcionin gjatë një periudhe të caktuar kohore të sasisë së sulfurit që nuk shkarkohet në ajër nga impianti, me sasinë e sulfurit që gjendet në lëndën djegëse të ngurtë që ka hyrë në impiant dhe e cila është përdorur në impiant gjatë të njëjtës periudhë kohore;

1.34. Lëndët të ngurta djegëse indigjene - nënkupton lëndët djegëse natyrale që djegën në impiantet e projektuara për djegie, posaçërisht për lokacionin ku është nxjerr lënda djegëse;

1.35. Biomasa - nënkupton:

1.35.1. Produkte që përbëhen prej çdo materie bimore nga bujqësia dhe pyjet të cilat mund të përdoren si lëndë djegëse me qëllim të rikuperimit të përmbajtjes së saj energjetike;

1.35.2. Mbeturinat në vijim:

1.35.2.1. Mbeturinat bimore nga bujqësia dhe pyjet;

1.35.2.2. Mbeturinat bimore nga industria e përpunimit të ushqimit, nëse nxehtësia e gjeneruar është rikuperuar;

1.35.2.3. Mbeturinat e fibrave bimore nga prodhimi i pulpës së pastër si dhe nga prodhimi i letrës nga pulpa, nëse ajo është bashkë-djegur në vendin e prodhimit dhe nxehtësia e gjeneruar është rikuperuar;

1.35.2.4. Mbeturinat nga tapat;

1.35.2.5. Mbeturinat e drurit me përjashtim të mbeturinave të drurit të cilat mund të përmbajnë përbërës organik të halogjenizuar apo metale të rënda si rezultat i trajtimit me mbrojtës apo veshje druri dhe e cila përfshin në veçanti, mbeturinat e tilla të drurit që dalin nga ndërtimi dhe mbeturinat e demolimit.

1.36. Impiant që djegë lloje të ndryshme të lëndëve djegëse - nënkupton çdo impiant që mund të djegë njëkohësisht njërin pas tjetrit nga dy ose më shumë lloje të lëndëve djegëse;

1.37. Turbina me gaz - nënkupton çdo pajisje rrotulluese e cila e shëndrron energjinë termike në punë mekanike e përbërë kryesisht nga kompresori, një pajisje termike në të cilën oksidohet lënda djegëse për të ngrohur lëngun punues dhe turbinën;

1.38. Motor me gaz - nënkupton një motor me djegie të brendshme i cili funksionon në bazë të ciklit Otto dhe përdor shkëndijën për ndezje në rastin e motorëve me lëndë djegëse të dyfishtë, ndezje me kompresion për të djegur karburantin;

1.39. Motor me naftë - nënkupton një motor me djegie të brendshme i cili funksionon në bazë të ciklit të naftës dhe përdor ndezjen me kompresion për të djegur karburantin;

1.40. Sistem i vogël i izoluar - nënkupton sistem të vogël me konsum prej me pak se 3000 GWh, ku me pak se 5% e konsumit vjetor merret nëpërmjet interkonjeksionit me sisteme të tjera;

1.41. Mbeturina - nënkupton mbeturinat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Mbeturina;

1.42. **Mbeturinat e rrezikshme** - nënkupton mbeturinat e rrezikshme siç janë përcaktuar në Ligjin përkatës për Mbeturina;

1.43. **Mbeturinat e përziera komunale** - nënkupton mbeturinat nga amvisëria si dhe mbeturinat industriale, tregtare dhe institucionale të cilat për nga natyra dhe përbërja e tyre janë të ngjashme me mbeturinat nga amvisëria siç janë përcaktuar në Ligjin përkatës për Mbeturina;

1.44. **Impliant për djegiet e mbeturinave** - nënkupton çdo njësi dhe pajisje statike ose të lëvizshme teknike e dedikuar për trajtimin termik të mbeturinave me ose pa rikuperimin e nxehtësisë së gjeneruar me djegie, përmes djegies nga oksidimi i mbeturinave si dhe proceseve të tjera të trajtimit termik si piroliza, procesi i gazifikimit ose plazmës, nëse substancat që rezultojnë nga trajtimi më pas janë të djegshme;

1.45. **Impliant me bashkë-djegje të mbeturinave** - nënkupton çdo njësi statike ose mobile, qëllimi kryesor i së cilës është prodhimi i energjisë ose prodhimi i produkteve materiale dhe e cila përdor mbeturinat si lëndë djegëse e rregullt ose shtesë, ose në të cilën mbeturinat trajtohen në mënyrë termike me qëllim të asgjësimit të tyre nëpërmjet djegies nga oksidimi i mbeturinave si dhe proceseve të tjera të trajtimit termik si piroliza, procesi i gazifikimit ose plazmës, nëse substancat që rezultojnë nga trajtimi më pas janë të djegshme;

1.46. **Kapaciteti i prodhimit** – nënkupton sasinë maksimale të produktit që mund të prodhohet për një periudhë të caktuar kohore në një pajisje ose kapaciteti i caktuar në një implant i specifikuar nga prodhuesi dhe i konfirmuar nga operatori, pa marrë parasysh kufizimet që vijnë nga regjimi i operimit;

1.47. **Kapaciteti nominal** - nënkupton sasinë e kapaciteteve të djegies së kaldajave nga të cilat përbëhet impianti me djegien e mbeturinave, ose impianti me bashkë-djegje të mbeturinave siç specifikohet nga prodhuesi dhe konfirmohet nga operatori, duke pasur parasysh vlerën kalorike të mbeturinave e shprehur në sasinë e mbeturinave të djegura në orë;

1.48. **Dioksinat dhe furanet** - nënkupton të gjithë dibenzo-p-dioksinetpoliklorinike dhe dibenzofuranet;

1.49. **Përbërës organik** - nënkupton çdo përbërës i cili përmban të paktën një element karbon dhe një ose më shumë elemente të hidrogjenit, halogjenit, oksigjenit, sulfurit, fosforit, silicit ose azotit, me përjashtim të oksideve të karbonit dhe karbonateve dhe bikarbonateve inorganike;

1.50. **Përbërës organik i avullueshëm** - nënkupton çdo përbërës organik si dhe fraksion të katranit që në temperaturën 293,15 K dhe në presion të avullit prej 0,01 kPa ose më shumë, ose duke pasur një avullueshmëri përkatëse sipas kushteve të veçanta të përdorimit;

1.51. **Tretës organik** - nënkupton çdo përbërës organik të avullueshëm i cili është përdorur si në vijim:

1.51.1. Vetëm ose në kombinim me agjentë të tjerë dhe pa iu nënshtruar një ndryshimi kimik, për të shpërbërë lëndën e parë, produktet ose materialet e mbeturinave;

1.51.2. Si agjentë i pastër për të shpërbërë ndotësit;

1.51.3. tretës;

1.51.4. medium shpërndarës;

1.51.5. rregullues i viskozitetit;

1.51.6. rregullues i tensionit sipërfaqësor;

1.51.7. plastifikues;

1.51.8. konservues.

1.52. **Mbështjellje** - nënkupton çdo preparat, përfshirë të gjithë tretësit organikë ose preparatet që përmbajnë tretës organik të nevojshëm për përdorimin e duhur që përdoret për të siguruar një shtresë të hollë me efekt dekorativ, mbrojtës ose efekt tjetër funksional në një sipërfaqe;

1.53. **Ministria** - nënkupton Ministrinë përgjegjëse për Mjedis;

1.54. **AMMK** - Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;

KAPITULLI II PROCEDURAT E LEJES

Neni 4 Autoriteti kompetent

1. Ministria është autoritet kompetent për shqyrtimin e kërkesës, vendimmarrjen për t'u pajisur me leje dhe monitorimin e zbatimit të obligimeve të përcaktuara me leje.

2. Ministria merr masat që asnjë implant për veprimtaritë e paraqitura në Shtojcën 1 të këtij ligji nuk funksionon pa leje.

3. Gjatë dhënies së lejes, Ministria përcakton masat për të parandaluar ndotjen përmes aplikimit të TMD -ve.

4. Dhënia e lejes për implantet e reja të përfshira në Shtojcën 1 të këtij ligji duhet të jenë në përputhshmëri me kushtet për vlerësimin e ndikimit në mjedis siç përcaktohet në vendimin e pëlqimit mjedisor.

5. Ministria lëshon leje që mbulon dy (2) ose më shumë impiante ose linja prodhuese që operojnë në të njëjtin vend nga i njëjti operator.

6. Kur një leje mbulon dy (2) ose më shumë impiante, në leje përcaktohen kushtet për secilin implant, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

7. Ministria lëshon leje për pjesë të caktuara të një impianti që operon nga operatorë të ndryshëm, në raste të tilla leja përcakton përgjegjësitë e secilit operator.

Neni 5 Detyrimet themelore të operatorit

1. Operatori operon me implantin në përputhje me kushtet e lejes nëse:

1.1. Janë marrë të gjitha masat parandaluese kundër ndotjes;

1.2. Janë zbatuar TMD;

- 1.3. Nuk është shkaktuar ndotje;
- 1.4. Gjenerimi i mbeturinave është parandaluar në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 1.5. Energjia, uji dhe lëndët e para përdoren në mënyrë efikase;
- 1.6. Janë marrë masat e duhura për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

2. Pas ndërprerjes përfundimtare të veprimtarisë merren masat e nevojshme për të shmangur çdo rrezik të ndotjes dhe kthimin e lokacionit të impiantit në gjendje të kënaqshme, të parapara në nenin 22 dhe 24 të këtij ligji.

Neni 6

Aplikimi për leje

1. Aplikacioni për leje dorëzohet nga personi i cili synon të operojë me impiantin.
2. Duke pasur parasysh natyrën e lejes, operatori paraqet informatat e nevojshme për ndikimet në mjedis dhe dokumentet tjera relevante.
3. Kur kërkesa për leje përfshin disa impiante ose pjesë të një impianti me operatorë të ndryshëm, procedurat administrative zhvillohen me operatorin që ka paraqitur kërkesën.
4. Ministria me akt nënligjor përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e plotësimit të aplikacionit për leje.
5. Ministria me akt nënligjor përcakton vlerën e tarifës për shërbimet lidhur me lejen.

Neni 7

Procedura e lejes

1. Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për leje në përbërje prej pesë (5) anëtarëve formohet me vendim nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë.
2. Mandati i komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni është tri (3) vite.
3. Pas pranimit të aplikacionit për leje, Komisioni njofton operatorin në formë elektronike për pranimin e aplikacionit.
4. Në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të aplikacionit për leje, Komisioni ua dërgon nga një (1) kopje:
 - 4.1. Autoritetit komunal në territorin e së cilës ndodhet impianti;
 - 4.2. AMMK-së;
5. Nëse dokumentacioni i cili shoqëron kërkesën është jo i plotë dhe informacionet e nevojshme nuk janë në dispozicion të Ministrisë, Komisioni kërkon nga aplikuesi informata dhe dokumentacion shtesë në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh për dorëzimin e tyre. Nëse dokumentet dhe informatat nuk dorëzohen brenda afatit të caktuar, kërkesa konsiderohet e refuzuar.
6. Komisioni obligohet që të verifikojë informatat e cekura rreth impiantit.
7. Pasi të kompletohet dokumentacioni dhe të plotësohen kushtet tekniko mjedisore, Ministria draftin e lejes e publikon në ueb faqen zyrtare të Ministrisë për informim të publikut në afat prej

tridhjetë (30) ditësh.

8. Operatori në bashkëpunim me Ministrinë, organizon debatin publik jo më herët se njëzetë (20) ditë dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data shpalljes në gazetën ditore në formë elektronike dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës në të cilën operatori zhvillon aktivitetin.

9. Ministria shqyrton vërejtjet dhe merr në konsideratë komentet e dala nga debati publik gjatë përgatitjes së propozim vendimit për Leje.

10. Komisioni përgatitë propozim vendimin me mendim profesional lidhur me kërkesat për leje brenda tridhjetë (30) ditësh pas debatit publik.

11. Ministria brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e marrjes së vendimit e publikon lejen në ueb faqen zyrtare të Ministrisë.

Neni 8

Përmbajtja dhe kushtet e lejes

1. Kushtet e paisjes me leje përfshijnë:

1.1. Masat e nevojshme në përputhje me kërkesat të parapara në nenin 5 dhe 12 të këtij ligji;

1.2. Përgjegjësitë e secilit operator, në raste kur leja është e vlefshme për një impiant që operon nga operatorë të ndryshëm;

1.3. Vlerat kufitare të emisionit për substancat e renditura në Shtojcën 2 të këtij ligji dhe për ndotësit e tjerë, të cilët mund të emitohen në sasi të konsiderueshme nga impianti në fjalë, duke marrë parasysh natyrën dhe potencialin e tyre për të transferuar ndotjen nga një mjedis në tjetrin dhe kur është e përshtatshme, parametrat ose masat ekuivalente teknike që plotësojnë ose rivendosin këto vlera kufitare.

1.4. Kërkesat për monitorimin e emisioneve të cilat përfshijnë:

1.4.1. Metodologjinë e matjes, shpeshtësinë dhe procedurën e vlerësimit;

1.4.2. Rezultatet e monitorimit të emisioneve që janë në dispozicion për të njëjtat periudha kohore dhe kushtet e referimit për nivelet që ndërlidhen me nivelin e TMD-së;

1.4.3. Vendndodhjen e pikave të mostrimit ose matjes për monitorimin e emisioneve;

1.4.4. Të gjitha rezultatet e monitorimit të regjistruara, përpunuara dhe paraqitura në atë menyrë që t'i mundësojnë Ministrisë të verifikojë të dhënat e dorëzuara nga operatori.

1.5. Zbatimi i TMD-së në impiant dhe identifikimi i atyre që janë përfshirë në konkluzionet e TMD-së;

1.6. Kërkesat për të siguruar dhe ditur se kur është e përshtatshme mbrojtja e tokës dhe ujërave nëntokësor;

1.7. Procedurat dhe metodat që përdoren për monitorimin dhe menaxhimin e mbeturinave të krijuara nga impianti, bëhet me prioritet sipas hierarkisë:

1.7.1. Parandalimi;

1.7.2. Përgatitja për ripërdorim;

1.7.3. Riciklimi;

1.7.4. Përpunimi dhe shfrytëzimi përfshirë rikuperimin e energjisë;

1.7.5. Deponimi.

1.8. Dispozitat për minimizimin e ndotjes ndërkufitare ose në distanca të gjata;

1.9. Sistemet dhe procedurat për trajtimin dhe kontrollin e të gjitha llojeve të emisioneve dhe mbeturinave, specifikimin e metodologjisë së matjes, frekuencës dhe procedurave për vlerësimin e matjeve, në rastin e pajisjeve të cekura në neni 16, paragrafi 4 nën-paragrafi 4.2, të këtij ligji, vihen në dispozicion në periudha kohore si me nivelet e emisionit të shoqëruara me TMD;

1.10. Masat që kanë të bëjnë me kushte të tjera nga ato të funksionimit normal, si: procesi i fillimit dhe ndalimit, rrjedhjet, keq funksionimet, ndalesat momentale dhe ndërprerja përfundimtare e punës së impiantit;

1.11. Kushtet në të cilat impianti duhet të mbyllet;

1.12. Detyrimi për të raportuar në Ministri në baza të rregullta deri në mbylljen e përhershme të veprimtarisë dhe të paktën çdo vit, me:

1.12.1. Informimin e bazuar në rezultatet e monitorimit të emisioneve të përmendura në paragrafin 1 nën-paragrafin 1.4 të këtij neni dhe të dhëna të tjera të nevojshme që i mundësojnë Ministrisë të verifikojë pajtueshmërinë me kushtet e lejes;

1.12.2. Përmbledhje vjetore e rezultateve të monitorimit të emisioneve që lejon krahasimin me nivelet e emisioneve të lidhura me TMD-në;

1.12.3. Aty ku janë zbatuar vlerat kufitare të emisioneve që tejkalojnë vlerat e emisioneve të lidhura me TMD-në, një përmbledhje e rezultateve të monitorimit të emisioneve që lejon krahasimin me nivelet e emisioneve të lidhura me TMD.

1.13. Kërkesat e duhura për mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e rregullt të masave të ndërmarra për parandalimin e emisioneve në tokë, ujëra nëntokësor sipas paragrafit 3 të këtij neni dhe kërkesave të duhura në lidhje me monitorimin periodik të tokës dhe ujërave nëntokësor lidhur me substancat e rrezikshme të cilat mund të gjenden në vend si dhe duke pasur parasysh mundësinë e kontaminimit të tokës dhe ujërave nëntokësor përreth impiantit;

1.14. Përshkrimi i ndikimit në mjedis kur është i zbatueshëm.

2. Komisioni dokumenton në shtojcë kushtet e lejes, arsyet e zbatimit të nenit 16, paragrafi 6 të këtij ligji, duke përfshirë rezultatin e vlerësimit dhe arsyetimin e kushteve të vendosura.

3. Vlerat kufitare të emisioneve plotësohen ose zëvendësohen me parametrat ose masat teknike të cilat sigurojnë mbrojtjen e mjedisit.

4. Konkluzionet e TMD-së dhe dokumentet e referimit të TMD-së, janë një referencë për përcaktimin e kushteve të lejes dhe vlerat kufitare të emisionit.

5. Ministria në leje mund të vendosë kushte rigoroze nga ato që merren nga përdorimi i TMD-së siç përshkruhen në konkluzionet e TMD-së.

6. Kur Ministria përcakton kushtet për autorizim të cilat bazohen në një TMD që nuk përshkruhet në asnjë prej përfundimeve në lidhje me TMD-në, do të sigurojë që:

6.1. Teknika është përcaktuar, duke i kushtuar vëmendje të veçantë kriterëve të përcaktuara në Shtojcën 3 të këtij ligji dhe

6.2. Kërkesat e nenit 16 të këtij ligji janë përmbushur.

7. Kur konkluzionet e TMD-së nuk përmbajnë nivele të emisioneve në lidhje me TMD-në, Komisioni siguron që teknika e referuar në nën-paragrafin 6.1 të këtij neni siguron një nivel të mbrojtjes së mjedisit të barabartë me TMD-në e përshkruara në konkluzionet e TMD-së.

8. Kur veprimtaria ose lloji i procesit të prodhimit i kryer brenda një impianti nuk mbulohet nga ndonjë konkluzion i TMD-së ose kur këto konkluzione nuk adresojnë të gjitha ndikimet e mundshme mjedisore të veprimtarisë ose procesit, Komisioni pas konsultimit paraprak me operatorin vendos kushtet e lejes në bazë TMD-së të përcaktuara për veprimtaritë ose proceset në fjalë, duke marrë parasysh në veçanti kriteret e përcaktuara në Shtojcën 3 të këtij ligji.

9. Për pikën 6.6 të Shtojcës 1 të këtij ligji, paragrafët 1 deri në 8 të këtij neni zbatohen pa e cenuar legjislacionin për përkujdesjen ndaj kafshëve.

10. Kohëzgjatja e lejes është dhjetë (10) vite. Operatori obligohet të aplikoj gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të vlefshmërisë së lejes së lëshuar. Zgjatja e vlefshmërisë së lejes bëhet në përputhje me nenin 6 të këtij ligji.

11. Ministria me akt nënligjor përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të lejeve të lëshuara.

KAPITULLI III KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR OPERATORIN

Neni 9 Fillimi i veprimtarisë

1. Pas paisjes me leje, operatori do të ketë një periudhë deri në një (1) vit për të filluar veprimtarinë.

2. Para fillimit të veprimtarisë, operatori duhet të paraqes një deklaratë në të cilën raporton datën e planifikuar të fillimit të veprimtarisë dhe pajtueshmërinë me kushtet e përcaktuara në leje.

3. Pasi të ketë filluar veprimtaria, inspektori do të kryejë një vizitë inspektimi në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji.

Neni 10 Mos përmbushja e kushteve

1. Operatori në rast të mos përmbushjes së kushteve të lejes, njofton Ministrinë dhe me kërkesë të saj ndërmerr masat e nevojshme për të përmbushur kushtet në kohën më të shkurtër të mundshme.

2. Operimi i impiantit ose pajisjeve shoqëruese të operatorit pezullohet deri sa të përmbushen kushtet, kur mos përmbushja e tyre paraqet rrezik për shëndetin e njeriut ose shkakton ndikim negativ në mjedis, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 11

Incidentet dhe aksidentet

1. Në rast të ndonjë incidenti apo aksidenti i cili ndikon në mjedis, operatori:

1.1. Njofton menjëherë Ministrinë;

1.2. Ndërmerr masa për të kufizuar pasojat mjedisore dhe për të parandaluar incidentet ose aksidentet e mundshme;

1.3. Ndërmerr masat e duhura shtesë, të domosdoshme për të kufizuar pasojat mjedisore dhe për të parandaluar incidentet ose aksidentet e mundshme.

Neni 12

Standardet e cilësisë së mjedisit

Kur një standard i cilësisë së mjedisit kërkon kushte më rigorozë se sa ato të arritshme me përdorimin e TMD, leja përfshinë masa shtesë pa cenuar masat e tjera që mund të merren për të qenë në përputhshmëri me standardet e cilësisë së mjedisit.

Neni 13

Dokumentet referente të TMD-së

Ministria me akt nënligjor përcakton procedurat e zhvillimit të dokumenteve të referimit dhe konkluzionet e TMD-së.

Neni 14

Zhvillimet në TMD

Operatori obligohet që të përcjellë zhvillimet e TMD-së dhe konkluzionet e përditësuara të TMD-së si dhe t'i publikojë ato në faqen zyrtare të tij.

Neni 15

Teknikat e reja

Ministria, kur është e përshtatshme, inkurajon zhvillimin dhe aplikimin e teknikave në zhvillim, veçanërisht për ato teknika të reja të identifikuara në dokumentet e referencës së TMD-ve.

Neni 16

Vlerat kufitare të emisioneve

1. Vlerat kufitare të emisioneve aplikohen në pikën ku emisionet dalin nga impianti dhe çdo intervenim teknik para kësaj pike nuk duhet të merret parasysht gjatë përcaktimit të këtyre vlerave.

2. Vlerat kufitare të emisioneve dhe matjet teknike sipas paragrafit 3 të këtij neni, duhet të bazohen në TMD, pa përshkruar përdorimin e ndonjë teknike ose teknologjie specifike.

3. Ministria cakton vlerat kufitare të emisioneve të cilat sigurojnë që në kushte normale të punës, emisionet nuk tejkalojnë nivelet emisioneve përmes:

3.1. vendosjes së vlerave kufitare të emisioneve që nuk i tejkalojnë nivelet e emisioneve të përshkruara në TMD-në, të cilat shprehen për periudhën e njëjtë apo më të shkurtër kohore dhe në kushte të njëjta me nivelet e emisioneve që ndërlidhen me TMD; ose

3.2. vendosjes së vlerave kufitare të emisioneve të ndryshme nga ato të referuara në nënparagrafin 3.1 të këtij neni për sa i përket vlerave, periudhave kohore dhe kushteve të referencës.

4. Në rastin kur zbatohet nënparagrafi 3.2 i këtij neni, Ministria të paktën çdo vit vlerëson rezultatet e monitorimit të emisioneve në mënyrë që të sigurojë se emisionet në kushte normale të operimit nuk tejkalojnë nivelet e emisioneve që ndërlidhen me TMD-në. Këto përjashtime duhet të rishikohen kur ripërtërihet leja.

5. Duke përjashtuar paragrafin 3 të këtij neni dhe pa u përjashtuar neni 12 i këtij ligji, Ministria në raste të veçanta përcakton vlerat kufitare pak më të lehta të emisioneve. Një përjashtim i tillë mund të aplikohet vetëm në rastin kur vlerësimi tregon se arritja e niveleve të emisioneve që ndërlidhet me TMD-në siç përshkruhet në konkluzionet e TMD-së, do të sjell në shpenzime disproporcionale më të larta krahasuar me përfitimet mjedisore për shkak të:

5.1. Vendndodhjes gjeografike ose kushteve lokale mjedisore të impiantit; ose

5.2. Karakteristikat teknike të impiantit.

6. Ministria me një shtojcë, bashkangjitur lejes dokumenton arsyet e aplikimit të nënparagrafit 5.1 të këtij neni, për kushtet e përcaktuara.

7. Vlerat kufitare të emisioneve të përcaktuara në përputhje me nënparagrafin 5.1 të këtij neni nuk duhet të tejkalojnë vlerat kufitare të emisioneve të legjislacionit në fuqi.

8. Ministria në çdo rast duhet të sigurohet se nuk është shkaktuar asnjë ndotje dhe është arritur nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit. Ministria rivlerëson zbatimin e paragrafit 5 të këtij neni si pjesë integrale e çdo rishikimi të kushteve të lejes në përputhje me nenin 20 të këtij ligji.

9. Ministria mund të bëjë përjashtime të përkohshme sipas kërkesave të paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni dhe paragrafit 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 të nenit 5 të këtij ligji, për testimin dhe përdorimin e teknikave të reja për një periudhë të përgjithshme kohore jo më të gjatë se nëntë (9) muaj, me kusht që pas periudhës së caktuar, veprimtaria arrin të paktën nivelet e emisioneve që ndërlidhen me TMD-në.

Neni 17

Monitorimi i emisioneve

1. Kërkesat e monitorimit sipas nën-paragrafit 1.4, paragrafi 1, të nenit 8 të këtij ligji kur zbatohen, bazohen në konkluzionet mbi monitorimin siç përshkruhet në konkluzionet e TMD-së.

2. Shpeshtësia e monitorimit periodik e përshkruar në nën-paragrafin 1.4 paragrafi 1 të nenit 8 të këtij ligji, përcaktohet në leje ose në rregullat e përgjithshme detyruese për çdo impiant.

3. Monitorimi periodik kryhet të paktën një (1) herë në pesë (5) vite për ujërat nëntokësore dhe një herë në dhjetë (10) vite për dheun, përveç nëse monitorimi i tillë bazohet në një vlerësim sistematik të rrezikut të kontaminimit.

Neni 18

Ndryshimet në impiante

1. Një modifikim në impiant konsiderohet kur në kushte normale të funksionimit synohet të futet një ndryshim që nuk është paraparë në lejen e dhënë i cili ndikon në karakteristikat, proceset e prodhimit, funksionimin dhe shtimin e pajisjeve.

2. Modifikimi i një impianti mund të jetë thelbësor ose jo thelbësor.

3. Operatori duhet të informojë Ministrinë paraprakisht për çdo ndryshim të planifikuar në karakteristikat, funksionimin ose zgjerimin e veprimtarive të impiantit që mund të ketë pasoja mjedisore.

4. Operatori kur planifikon të kryej një modifikim jo thelbësor të impiantit do të njoftojë Ministrinë. Ky njoftim do të shoqërohet me detaje të dokumenteve mbështetëse për arsyetimin e ndryshimit thelbësor sipas nenit 6 të këtij ligji.
5. Në rast se ndryshimi në impiant nënkupton një ndryshim të kushteve të lejes edhe nëse nuk është një ndryshim thelbësor, Ministria ndryshon kushtet e lejes sipas Ligjit përkatës për procedurë të përgjithshme Administrative dhe publikon në web faqen e Ministrisë.
6. Çdo ndryshim në natyrën e funksionimit ose të zgjerimit të impiantit do të konsiderohet thelbësor nëse ndryshimi ose zgjerimi arin vlerat e percaktuara në Shtojcën 1 të këtij ligji.
7. Operatori nuk do të lejohet të kryejë ndonjë ndryshim thelbësor derisa leja të përditësohet në përputhje me procedurat dhe dispozitat e nenit 6 të këtij ligji.
8. Kërkesa për leje për ndryshim thelbësor përfshinë dokumentet që arsyetojnë natyrën thelbësore të ndryshimit që kryhet si dhe projektin bazë për pjesët e pajisjeve të prekura nga ky ndryshim.

Neni 19

Kriteret për ndryshime thelbësore

1. Konsiderohet si thelbësore kur ndryshimi i impiantit paraqet një rrezik të madh për sigurinë, shëndetin e njerëzve ose mjedisin si dhe nëse plotësohet ndonjë nga kriteret e mëposhtme:
 - 1.1. Çdo zgjerim ose ndryshim që arrin pragjet e kapacitetit të percaktuara në Shtojcën 1, ose nëse nuk përfshihet në procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedis;
 - 1.2. Një rritje prej më shumë se 50% të kapacitetit prodhues në pajisjet e njësive prodhuese;
 - 1.3. Një rritje prej më shumë se 50% të sasive të konsumit të ujit, lëndëve të para ose energjisë;
 - 1.4. Një rritje prej më shumë se 25% në masë të emisioneve të ndotësve të ajrit që shfaqen në leje ose të emisioneve totale të ajrit të prodhuara në secilin prej burimeve të emisioneve si dhe futja e ndotësve të rinj në sasi të konsiderueshme;
 - 1.5. Një rritje në masë të emisionit më të madhe se 25% ose 25% të përqendrimit të shkarkimeve të ndonjë prej substancave parësore ose futja e substancave të reja në leje në përputhje me dispozita ligjore të legjislacionit përkatës ujqor;
 - 1.6. Nëse ka një rritje më shumë se dhjetë (10) ton në vit në gjenerimin e mbeturinave të rrezikshme dhe në rastet e ndryshimit strukturor të procesit ose një rritje prej më shumë se 25% të sasisë totale të mbeturinave të rrezikshme të gjeneruara, llogaritur në sasinë e maksimale të prodhimit të mbeturinave të rrezikshme;
 - 1.7. Një rritje në prodhimin e mbeturinave jo të rrezikshme prej më shumë se pesëdhjetë (50) ton në vit për sa kohë që zgjatë një rritje prej më shumë se 50% të mbeturinave jo të rrezikshme, përfshirë mbeturinat inerte, të llogaritura në sasinë maksimale të prodhimit të mbeturinave;
 - 1.8. Ndryshimi në funksionimin e një impianti të djegies ose bashkë-djegies së mbeturinave që funksionon vetëm për trajtimin e mbeturinave jo të rrezikshme, që e shndërron në një strukturë që përfshin djegien ose bashkë-djegien e mbeturinave të rrezikshme dhe që përfshihet në Shtojcën 1 të këtij ligji.
2. Renditja e kriterëve sasiore dhe cilësore të parapara në paragrafin 2 të këtij neni janë jo-

kufizuese. Komisioni mund të vendosë kritere kufizuese në raste të caktuara që rrjedhin nga rrethanat specifike.

3. Nëse kryhen ndryshime të njëpasnjëshme jo thelbësore në një impiant para shqyrtimit të lejes, gjatë periudhës së shqyrtimit, shuma e dy (2) ose më shumë ndryshimeve jo thelbësore që plotësojnë ndonjë nga kriteret në paragrafin 1 të këtij neni do të konsiderohet si modifikim thelbësor.

4. Nëse ndryshimi thelbësor kërkohet pas një ndryshimi tjetër jo-thebësor, para shqyrtimit të lejes ose gjatë periudhës së shqyrtimit, të gjitha ndryshimet e mëparshme jo thelbësore duhet të shqyrtohen së bashku sipas procedurave të parapara në nenin 18 të këtij ligji, pas kësaj leja ndryshohet.

Neni 20

Rishikimi dhe përditësimi i kushteve të lejes

1. Komisioni rishikon kushtet e lejes:

1.1. Në rast të ndotjes së konsiderueshme të shkaktuar si rezultat i veprimtarisë së impiantit, nëse vlerat ekzistuese kufitare të emisioneve të vendosura në leje duhet të rishikohen ose të përfshihen vlerat e reja;

1.2. Siguria në punë kërkon përdorimin e teknikave tjera;

1.3. Zvogëlimet e konsiderueshme të emisioneve janë të mundshme pa imponuar kosto të lartë si rezultat i ndryshimeve të mëdha në TMD;

1.4. Konkluzionet e reja të TMD-së në lidhje me veprimtaritë lëshohen në përputhje me nenin 12 të këtij ligji;

1.5. Kërkohet nga rregullat e përgjithshme detyruese të zbatueshme për impiantin dhe standardet e reja ose të rishikuara të cilësisë mjedisore.

2. Bazuar në paragrafin 1 nën-paragrafin 1.4 të këtij neni, Ministria përditëson lejen përkatëse brenda pesë (5) viteve nga momenti i miratimit të konkluzionit të TMD-së, në mënyrë që të sigurojë që:

2.1. Të gjitha kushtet e lejes për impiantet në fjalë janë rishikuar dhe janë të përditësuar në përputhje me nenin 16 të këtij ligji;

2.2. Impiantet në fjalë janë në përputhje me kushtet e lejes.

3. Me kërkesë të Ministrisë, operatori duhet të paraqes të gjitha informatat e nevojshme për rishikimin e kushteve të lejes, përfshirë rezultatet e monitorimit të emisioneve dhe të dhëna të tjera, të cilat mundësojnë krahasimin e funksionimit të impiantit me TMD-në.

4. Ministria rishikon kushtet e lejes, duke u bazuar në rezultatet nga monitorimi dhe inspektimet.

5. Në rastin kur nuk përfshihen ndonjë prej konkluzioneve të TMD-së kushtet e lejes do të rishikohen dhe nëse është e nevojshme do të përditësohen kur zhvillimet në TMD lejojnë një zvogëlim të rëndësishëm të emisioneve.

Neni 21

Transferi i lejes

1. Në rast se operatori planifikon të transferojë lejen te ndonjë person tjetër, operatori dhe personi tjetër duhet të paraqesin një kërkesë të përbashkët në Ministri.

2. Kërkesa për transfer përmban:

- 2.1. Emrin, adresën dhe numrin e telefonit të operatorit;
- 2.2. Emrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit tek i cili transferohet leja;
- 2.3. Leja origjinale;
- 2.4. Vendimi i transferit të pëlqimit mjedisor;
- 2.5. Informatat për kompetencat, mundësinë dhe burimet ekonomike të personit tek i cili transferohet leja;
- 2.6. Çertifikatën e biznesit të pronarit të tanishëm dhe personit tek i cili transferohet leja;
- 2.7. Fletëpagesa e tarifës për transfer.

3. Komisioni aprovon kërkesën për transferimin e lejes nëse personi të cilit do t'i transferohet leja i plotëson kërkesat sipas këtij ligji.

4. Komisioni informon operatorin me shkrim lidhur me miratimin e transferimit duke specifikuar datën e hyrjes në fuqi të transferimit.

5. Komisioni refuzon transferimin e lejes dhe njofton operatorin në formë të shkruar duke cekur arsyet për refuzim.

6. Komisioni kërkon me shkrim nga operatori çdo informatë tjetër që e konsideron të nevojshme për marrjen e vendimit për transfer sipas këtij neni.

7. Nëse informatat e kërkuara nuk janë dorëzuar në Ministri brenda tridhjetë (30) ditëve, Komisioni konsideron kërkesën për transfer si të tërhequr dhe e njofton operatorin lidhur me këtë vendim.

Neni 22**Ndërprerja e përkohshme dhe mbyllja e veprimtarisë**

1. Operatori duhet të informojë Ministrinë gjashtëdhjetë (60) ditë para ndërprerjes së përkohshme të veprimtarisë ku specifikon shkaqet e ndërprerjes së veprimtarisë, arsyet, kohen e planifikuar dhe çdo arsye tjetër që mund të justifikojë ndërprerjen e veprimtarisë.

2. Ndërprerja e përkohshme e veprimtarisë nuk mund të zgjasë më tepër se dy (2) vjet nga data e informimit në Ministri. Gjatë periudhës në të cilën përkohësisht është mbyllur impianti duhet:

- 2.1. Të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara në lejen aktuale;
- 2.2. Të rifillojë veprimtarinë në përputhje me kushtet e lejes në njoftimin e Ministrisë;
- 2.3. Të ndryshojë pronësinë e impiantit ose veprimtarisë pasi të njoftojë Ministrinë;
- 2.4. Operatori i ri duhet të vazhdojë -me të njëjtat kushte të lejes aktuale pasi nuk konsiderohet impiant i ri;
- 2.5. T'i raportojë Ministrisë paraprakisht nëse periudha e mbylljes planifikohet të zgjatet ose mbyllet përgjithmonë.

3. Pas dy (2) viteve nga informimi i ndërprerjes së përkohshme, pa pasur nevojë që operatori të rifillojë veprimtarinë, Ministria do të kryejë një verifikim nëse është në përputhje me veprimtarinë

e ndërprerë, kushtet në lidhje me ndërprerjen e veprimtarive të përcaktuara në leje.

4. Kur verifikimi është pozitiv, Ministria nxjerr vendim për mbylljen e impiantit dhe revokimin e lejes.

Neni 23 **Revokimi i lejes**

1. Leja mund të revokohet në rast se:

- 1.1. Vërtetohet se operatori nuk i ka respektuar obligimet e përcaktuara në leje;
- 1.2. Konstatohet se operatori ka dhënë shënime të pa sakta dhe deklarime të rrejshme;
- 1.3. Operatori nuk fillon operimin e impiantit brenda një (1) viti nga dita e marrjes së lejes;
- 1.4. Operatori nuk kryen monitorimin dhe nuk paraqet të dhëna në përputhje me këtë ligj;
- 1.5. Operatori nuk vepron sipas kërkesës së inspektorit ose nuk merr masat e urdhëruara brenda afatit të caktuar.

2. Ministria fillon procedurën për revokimin, anulimin apo shfuqizimin e lejes dhe informon operatorin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve lidhur me vendimin.

3. Vendimi për revokimin, anulimin apo shfuqizimin e lejes përcakton gjithashtu masat e detyrueshme për operatorin që pas përfundimit të veprimtarisë së impiantit, zona ku është zhvilluar veprimtaria duhet të rehabilitohet në mënyrë që të shmanget rreziku për mjedisin, shëndetin e njeriut dhe të mirat materiale.

Neni 24 **Raporti bazë i tokës dhe ujërave nëntokësor**

1. Pa cenuar dispozitat ligjore të përcaktuara në aktin ligjor përkatës për klasifikimin e trupave ujore nëntokësore si dhe aktin ligjor përkatës për vlerat kufitare të emisioneve të materieve ndotëse në tokë, Ministria përcakton kushtet e lejes për të siguruar përputhshmërinë me paragrafët 6 dhe 7 të këtij neni, pas ndërprerjes definitive të veprimtarive të impiantit.

2. Kur veprimtaria përfshin përdorimin, prodhimin ose shkarkimin e substancave të rrezikshme dhe duke pasur parasysh mundësinë e kontaminimit të tokës dhe ujërave nëntokësore në vendin e impiantit, operatori duhet të përgatit dhe t'i paraqes Ministrisë raportin para fillimit të operimit të impiantit ose para përditësimit të lejes për impiantin si dhe para mbylljes përfundimtare të impiantit.

3. Raporti përmban informata për gjendjen e kontaminimit të tokës dhe ujërave nëntokësore, në mënyrë që të bëhet një krahasim sasior me gjendjen, pas ndërprerjes definitive të veprimtarive të parashikuara në paragrafin 6 të këtij neni.

4. Raporti përmban këto informata:

- 4.1. Mbi shfrytëzimin aktual dhe të mëhershëm të lokacionit;
- 4.2. Nëse janë në dispozicion rezultatet ekzistuese për matjet e tokës dhe ujërave nëntokësore, të cilat paraqesin gjendjen në kohën e hartimit të raportit ose sipas rastit, matjet e reja të dheut dhe ujërave nëntokësore, duke pasur parasysh mundësinë e kontaminimit të dheut dhe ujërave nëntokësor nga përdorimi, prodhimi ose shkarkimi i substancave të rrezikshme nga ana e impiantit.

5. Kur rezultatet janë në përputhje me vlerat kufitare të emisioneve të materieve ndotëse në tokë atëherë këto rezultate mund t'i bashkëngjiten raportit bazë.

6. Pas ndërprerjes definitive të veprimtarive, operatori duhet të vlerësoj gjendjen e kontaminimit të tokës dhe ujërave nëntokësore nga substancat e rrezikshme të përdorura ose shkarkuara nga ana e impiantit. Në rastin kur impianti shkaktin ndotje të tokës dhe ujërave nëntokësore nga substancat e rrezikshme operatori duhet të ndër marrë masat e nevojshme për të trajtuar atë ndotje në mënyrë që ta kthejë vendin në gjendjen e mëparshme.

7. Pa paragjykuar paragrafin 6 të këtij neni edhe nëse nuk kërkohet të përgatit një raport bazë referuar në paragrafin 2 të këtij neni pas ndërprerjes përfundimtare të veprimtarive, operatori duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme që kanë për qëllim largimin, kontrollimin, ruajtjen ose zvogëlimin e substancave të rrezikshme, në mënyrë që vendndodhja të mos paraqitet më si ndonjë rrezik për shëndetin e njeriut ose mjedisin për shkak të kontaminimit të tokës dhe ujërave nëntokësore si rezultat i veprimtarive të impiantit.

KAPITULLI IV QASJA NË INFORMATA

Neni 25

Qasja në informata dhe pjesëmarrja e publikut në procedurën e lëshimit të lejes

1. Ministria siguron që publikut të interesuar i është ofruar mundësia për të marrë pjesë në procedurat e:

- 1.1. Dhënies së lejes për impiantet e reja dhe impiantet ekzistuese;
- 1.2. Dhënies së lejes për ndonjë ndryshim thelbësor;
- 1.3. Dhënien ose përditësimin e lejes për impiante, në rastet të zbatimit të paragrafit 4 të nenit 16;
- 1.4. Përditësimin e lejes ose kushteve të lejes për impiante, në përputhje me nenin 20.

2. Procedurat e cekura në paragrafin 1 të këtij neni janë të përcaktuara në Shtojcën 4 të këtij ligji.

3. Pas marrjes së vendimit për dhënien, ose ripërtëritjen e lejes, Ministria publikon në uebfaqe zyrtare informatat e mëposhtme:

- 3.1. Përmbajtjen e vendimit, përfshirë edhe një kopje të lejes dhe çdo përditësim pasues;
- 3.2. Arsyet mbi të cilat është bazuar vendimi;
- 3.3. Rezultatet e konsultimeve të zhvilluara para marrjes së vendimit dhe një shpjegim se si janë marrë parasysh ato në vendim;
- 3.4. Titullin e dokumenteve të referimit të TMD-së relevante me impiantin apo veprimtarinë;
- 3.5. Kushtet e lejes të përmendura në nenin 8, përfshirë vlerat kufitare të emisioneve në lidhje me TMD-në dhe nivelet e emisioneve që ndërlidhen me TMD-në;
- 3.6. Me rastin e dhënies së një përjashtimi në përputhje me paragrafin 4 të nenit 16 të këtij ligji, arsyet specifike për atë përjashtim në bazë të kriterëve të përcaktuara në atë paragraf dhe kushtet e imponuara.

4. Ministria në uebfaqe zyrtare publikon:

4.1. Informatat për masat e ndërmarra nga operatori pas mbylljes të veprimtarive në përputhje me nenin 22 të këtij ligji;

4.2. Rezultatet e monitorimit të emisioneve të kërkuara në kushtet e lejes të lëshuara nga Ministria.

Neni 26
Efektet ndërkufitare

1. Kur Ministria është e informuar se funksionimi i një impianti mund të ketë efekte të konsiderueshme anësore në mjedisin e një shteti fqinj, vendos në dispozicion të shtetit tjetër çdo informatë të kërkuar.

2. Informatat e tilla shërbejnë si bazë për çdo konsultim të nevojshëm në kuadër të marrëdhënieve bilaterale ndërmjet dy (2) shteteve në baza të ndërsjella dhe të barabarta.

3. Rezultatet e çdo konsultimi në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni duhet të merren në konsideratë kur Ministria të merr vendimin për leje.

4. Ministria përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme e njofton ose është në dispozicion të informimit të shtetit fqinj për vendimin e marrë.

KAPITULLI V
MBIKQYRJA INSPEKTUESE

Neni 27
Mbikëqyrja inspektuese

Inspektori mjedisor i Ministrisë kryen mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligji si dhe akteve nënligjore, për parandalimin, kontrollin e integruar të ndotjes nga veprimtaritë e ndryshme industriale të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 28
Inspektimet mjedisore

1. Ministria krijon planin e inspektimeve mjedisore të impianteve i cili trajton shqyrtimin e ndikimeve mjedisore nga impiantet.

2. Operatori siguron që inspektorit mjedisor t'i ofron ndihmën e nevojshme, në mënyrë që t'iu mundësojnë kryerjen e veprimtarive në çdo vizitë në terren, të marrin mostra dhe të mbledhin çdo informatë të nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre për qëllime të këtij ligji.

3. Inspektori mjedisor siguron që të gjitha impiantet janë të përfshira në planin për inspektime mjedisore dhe se ky plan është rishqyrtuar rregullisht dhe nëse është e nevojshme përditësohet.

4. Çdo plan për inspektim mjedisor përfshin:

4.1. Vlerësim të përgjithshëm të çështjeve përkatëse mjedisore;

4.2. Zonën gjeografike të mbuluar nga plani i inspektimit;

4.3. Regjistrin e impianteve të mbuluara nga plani;

4.4. Procedurat për hartimin e programeve për inspektimet e zakonshme mjedisore, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni;

4.5. Procedurat për inspektimet e jashtëzakonshme mjedisore në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni;

4.6. Dispozitat mbi bashkëpunimin ndërmjet niveleve të ndryshme të inspektimit nëse është e nevojshme,

5. Bazuar në planet e inspektimit, inspektori mjedisor rregullisht harton plane për inspektime të zakonshme mjedisore, duke përfshirë shpeshtësinë e vizitave në terren për lloje të ndryshme të impianteve.

6. Periudha ndërmjet dy (2) vizitave në terren bazohet në një vlerësim sistematik të impianteve nga rreziqet mjedisore dhe nuk duhet të kalojë një (1) vit për impiantet që paraqesin rreziqe të larta dhe tri (3) vite për impiantet që paraqesin rreziqe më të ulëta.

7. Nëse inspektimi identifikon një rast të rëndësishëm të mos përmbushjes me kushtet e lejes, një vizitë shtesë në terren duhet të kryhet brenda gjashtë (6) muajve pas inspektimit.

8. Vlerësimi sistematik i rreziqeve mjedisore duhet të bazohet në të paktën njërën prej kritereve të mëposhtme:

8.1. Ndikimet e mundshme dhe aktuale nga impiantet në fjalë mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin, duke pasur parasysh nivelet dhe llojet e emisioneve, ndjeshmërinë në mjedisin lokal dhe rrezikun nga aksidentet;

8.2. Të dhënat e përmbushjes me kushtet e lejes.

9. Inspektimet e jashtëzakonshme mjedisore kryhen me qëllim të hetimit të ankesave mjedisore, aksidenteve dhe incidenteve mjedisore dhe rasteve të mos përmbushjes së kushteve të lejes.

10. Pas çdo vizite në terren Inspektori Mjedisor përgatit një raport në të cilin përshkruan gjetjet përkatëse lidhur me përmbushjen e kushteve të lejes si dhe me konkluzionet nëse është i nevojshëm ndonjë veprim i mëtejshëm.

11. Raporti duhet t'i dorëzohet operatorit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas vizitës në terren.

12. Inspektori mjedisor siguron që operatori do t'i ndërmerr menjëherë të gjitha veprimet e nevojshme të identifikuar në raport.

KAPITULLI VI DISPOZITAT NDËSHKIMORE DHE E DREJTA E ANKESËS

Neni 29 Masat ndëshkimore

1. Masat ndëshkimore të përcaktuara me këtë ligj shqiptohen nga inspektori mjedisor.

2. Mjetet financiare të mbledhura nga masat ndëshkimore derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

3. Kushtet për shqiptimin e gjobave, afateve, procedurat, ankesat dhe çdo çështje tjetër që nuk është përcaktuar me këtë ligj zbatohen sipas legjislacionit për kundërvajtje.

4. Gjoha në të holla për masën ndëshkuese e shqiptuar nga inspektori mjedisor paguhet në afat prej tridhjetë (30) ditë nga dita e pranimi të vendimit për ekzekutimin e vendimit të inspektorit mjedisor.

5. Nëse personi i mbikëqyrur pas skadimit të afatit prej tridhjetë (30) ditë nuk i sjell inspektorit mjedisor dëshmi për pagesën e gjobës, ekzekutimi i ndëshkimit do të bëhet në përputhje me dispozita ligjore të ligjit për procedurën përmbartimore.

Neni 30 **Sanksionet kundërvajtëse me gjobë**

1. Me gjobë në të holla prej njëzetmijë (20,000) deri në dyzetmijë (40,000) euro dënohet personi juridik nëse:

- 1.1. Operon me impiant pa leje;
- 1.2. Nuk vepron në përputhje me kushtet e përcaktuara në leje;
- 1.3. Nuk i paraqet Ministrisë rezultatet e monitorimit;
- 1.4. Nuk e njofton Ministrinë për planifikimin e ndryshimit në operim;
- 1.5. Nuk i paraqet Ministrisë raportin vjetor për performancën e veprimtarisë për të cilën është lëshuar leja;
- 1.6. Nuk zbaton masat e përcaktuara nga Ministria pas përfundimit të veprimtarisë në zona ku është zhvilluar veprimtaria në mënyrë që të shmangët rreziku për mjedisin, shëndetin e njeriut dhe të mirat materiale;
- 1.7. Nuk ndërmerr masat e duhura plotësuese të domosdoshme në kohën sa më të shkurtër në rast të avarive për të kufizuar pasojat mjedisore dhe për të parandaluar incidentet ose aksidentet e mundshme;
- 1.8. Nuk aplikon për leje ose ndryshim të kushteve të lejes para prezantimit të ndryshimit të operimit.

2. Me gjobë në të holla prej pesëqind (500) deri në katërmijë (4,000) euro dënohet personi përgjegjës i personit juridik.

3. Për shkelje nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet personi fizik i cili ushtron biznes individual, me gjobë prej dyqind (200) deri në pesë mijë (5,000) euro.

4. Shqiptimi i sanksioneve kundërvajtëse me gjobë të përcaktuara në këtë ligj bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për kundërvajtje.

Neni 31 **E drejta për ankesë**

1. Kundër vendimit për refuzimin e lejes dhe një vendimi tjetër përfundimtar sipas këtij ligji, përfshirë vendimet të lëshuara në procedurë të inspektimit, lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

2. Komisioni i ankesave i themeluar me vendim të ministrisë është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave sipas paragrafit 1 të këtij neni.

KAPITULLI VII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 32 Dispozita kalimtare

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj nxirren brenda gjashtë (6) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Neni 33 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes dhe Shtojcat.

Neni 34 Shtojcat

Pjesë përbërëse e këtij ligji janë shtojcat 1, 2, 3 dhe 4.

Neni 35 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-145
08 mars 2023**

Shpallur me dekretin Nr. DL-57/2023, datë 24.03.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu

SHTOCJA 1

KATEGORITË E AKTIVITETEVE INDUSTRIALE

Vlerat e pragut të dhëna më poshtë në përgjithësi i referohen kapacitetit prodhues ose prodhimit.

Kur një operator kryen më tepër se një veprimtari që bie brenda të njëjtit nën seksion në të njëjtin impiant ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e veprimtarive të tilla mbledhen së bashku.

Për aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave kjo llogaritje zbatohet në nivelin e aktiviteteve 5.1, 5.3.1 dhe 5.3.2.

1. Industritë e energjisë

1.1. Djegia e lëndëve djegëse në impiante me një normë me inputin total termik prej 50 MW ose më shumë;

1.2. Rafinimi i vajrave minerale dhe gazit;

1.3. Prodhimi i koksit;

1.4. Gazifikimi ose lëngëzimi:

1.4.1. thëngjillit;

1.4.2. karburantet tjera në impiantet me inputin total nominal termik prej 20 MW ose më shumë.

2. Prodhimi dhe përpunimi i metaleve

2.1. Minerali i metalit (përfshirë mineralet që përmbajnë sulfur) pjekje ose llum.

2.2. Prodhimi i hekurit dhe çelikut (bashkimi primar ose sekondar) duke përfshirë derdhjen e vazhdueshme, me një kapacitet që tejkalon 2.5 ton në orë.

2.3. Përpunimi i metaleve me ngjyra:

2.3.1. presat rrokullise e çelikut e nxehtë që tejkalojnë 20 ton çelik të papërpunuar në orë;

2.3.2. farkëtaritë me çekiçë energjia e të cilave i kalon 50 kiloxhul për çekan ku fuqia nxehtë e përdorur e kalon 20 MW;

2.3.3. aplikimi i shtresave mbrojtëse me metal të përzier të inputit që tejkalon 2 ton të çelikut papërpunuar në orë.

2.4. Shkritoret e metaleve me ngjyra me një kapacitet prodhues që tejkalon 20 ton në ditë.

2.5. Përpunimi i metaleve pa ngjyra:

2.5.1. prodhimi i metaleve pa ngjyra nga mineralet, koncentratet ose lëndë dytësore të përpunimeve metalurgjike, kimike ose elektrolitike;

2.5.2. shkrirja, duke përfshirë edhe vendosjen në kallëpe të metaleve me ngjyrë, përfshirë prodhimet e ripërpunuara dhe funksionimin e shkritoreve të metaleve pa ngjyra, me një kapacitet shkrirës që tejkalon 4 ton në ditë për plumbin dhe kadmiumin ose 20 ton në ditë për të gjitha metalet e tjera.

2.6. Trajtimi sipërfaqësor i metaleve ose materialeve plastike duke përdorur proces elektrolitik ose kimik, ku vëllimi i vaskave përpunuese tejkalon 30 m³.

3. Industria e Mineraleve

3.1. Prodhimi i çimentos, gëlqeres dhe oksidit të magnezit:

3.1.1. prodhimi i klinkerit të çimentos në furra rrotulluese me një kapacitet prodhues që kalon 500 ton në ditë ose në furrat tjera me një kapacitet prodhues që tejkalon 50 ton në ditë;

3.1.2. prodhimi i gëlqeres në furrat me një kapacitet prodhues që tejkalon 50 ton në ditë;

3.1.3. prodhimi i oksidit të magnezit në furrat me një kapacitet prodhues që tejkalon 50 ton në ditë.

3.2. Prodhimi i asbestit apo prodhimin e produkteve me bazë azbest;

3.3. Prodhimi i qelqit përfshirë fibrat e xhamit me një kapacitet shkrirës që tejkalon 20 ton në ditë;

3.4. Shkrirja e substancave minerale, përfshirë prodhimin e fibrave minerale me kapacitet shkrirës që tejkalon 20 ton në ditë;

3.5. Prodhimi i produkteve të qeramikës me anë të pjekjes, në veçanti tjegulla çatie, tulla, tulla zjarrruduese, tjegulla, veshje guri ose porcelani me një kapacitet prodhues që tejkalon 75 ton në ditë dhe/ose me një kapacitet furrë që tejkalon 4 m³ dhe me një dendësi palosëse për furrë që tejkalon 300 kg/m³.

4. Industria kimike

Për qëllim të këtij seksioni, prodhimi brenda kuptimit të kategorive të veprimtarive të përfshira në këtë seksion nënkupton prodhimin në shkallë industriale nga përpunimi kimik ose biologjik i substancave ose grupeve të substancave të renditura në pikat 4.1 deri 4.6.

4.1. Prodhimi i kimikateve organike të tilla si:

4.1.1. hidrokarbure të thjeshta (lineare ose ciklike, të ngopura apo të pangopura, alifatike ose aromatike);

4.1.2. hidrokarbure që përmbajnë oksigjen të tilla si alkoolët, aldehidet, ketonet, acidet karboksilike, esteret dhe përzierjet e etereve, acetatet, eteret, peroksidet dhe rrëshira epokside;

4.1.3. hidrokarburet sulfurore;

4.1.4. hidrokarburet azotike siç janë aminet, amidet, nitro kompozimet e azotit, përbërjet azotike ose përbërësit nitrik, nitrilet, cianatet, izocianatet;

4.1.5. hidrokarburet që përmbajnë fosfor;

4.1.6. hidrokarbure halogenike;

4.1.7. bashkë dyzimet organo-metalike;

4.1.8. materialet plastike (polimere, fibra sintetike dhe fibra me bazë celuloze);

4.1.9. goma sintetike;

4.1.10. ngjyra dhe pigmente;

4.1.11. agjentët sipërfaqësorë aktiv dhe surfaktantet.

4.2. Prodhimi i kimikateve inorganike të tilla si:

4.2.1. gazërat si: amoniaku, klori ose hidrogjen kloruri, fluori ose hidrogjen fluori, oksidet e karbonit, komponimet e sulfurit, oksidet e azotit, hidrogjeni, dioksidi i sulfurit, klori karbonik;

4.2.2. acidet si: acidi i kromit, acid hidrofluorik, acid fosforik, acid nitrik, acid klorhidrik, acid sulfurik, acid sulfuror, oleum;

4.2.3. bazat si hidroksid amoniumi, hidroksid kaliumi, hidroksid natriumi;

4.2.4. kripërat si: kloruri i amonit, kloruri i kaliumit, karbonat kaliumi, karbonat natriumi, perborate, nitrat argjenti;

4.2.5. jometalet, oksidet e metaleve ose komponime tjerë organik si karbiti i kalciumit, silici, karbiti i silicit.

4.3. Prodhimi i fosforit, azotit ose plehrave me bazë (plehera të thjeshta ose të përbëra)

4.4. Prodhimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve ose të biocideve;

4.5. Prodhimi i produkteve farmaceutike, duke përfshirë intermediatet;

4.6. Prodhimi i eksplozivëve.

5. Menaxhimi i mbeturinave

5.1. deponimi ose përpunimi i mbeturinave të rrezikshme me një kapacitet që tejkalon 10 ton në ditë, përfshirë një ose më shumë nga veprimtaritë:

5.1.1. përpunimi biologjik;

5.1.2. përpunimi fiziko-kimik;

5.1.3. përzierja ose përzierja para dorëzimit në ndonjë nga veprimtarit e tjera të renditura në pikat 5.1 dhe 5.2;

5.1.4. ripaketimi para dorëzimit në ndonjë nga aktivitetet e tjera të renditura në pikat 5.1 dhe 5.2;

5.1.5. zbutja me tretës / rigjenerimi;

5.1.6. riciklimi / rikuperimi i materialeve inorganike përveç metaleve ose përbërësve të metaleve;

5.1.7. rigjenerimi i acideve ose bazave;

5.1.8. përpunimi i komponentëve të përdorur për zvogëlimin e ndotjes;

5.1.9. përpunimi i komponentëve nga katalizatorët;

5.1.10. ri-rafinimi i vajit ose ripërdorimet e tjera të naftës;

5.1.11. mbyllje e sipërfaqes.

5.2. deponimi ose përpunimi i mbeturinave në impiantet e djegies mbeturinave ose në impiantet e bashkë-djegies të mbeturinave:

5.2.1. për mbeturinat jo të rrezikshme me kapacitet mbi 3 ton në orë;

5.2.2. për mbeturina të rrezikshme me një kapacitet që tejkalon 10 tonë në ditë.

5.3. Deponimi i mbeturinave jo të rrezikshme me një kapacitet që tejkalon 50 ton në ditë që përfshinë një ose më shumë prej veprimtarive të pasuara vijuese, dhe duke përjashtuar veprimtaritë lidhur me trajtimin ujërave të zeza urbane:

5.3.1.1. trajtimi biologjik;

5.3.1.2. trajtimi fiziko-kimik;

5.3.1.3. para-trajtimi i mbeturinave për djegie ose bashkë-djegia;

5.3.1.4. trajtimi i llumit dhe hirit;

5.3.1.5. përpunimi në grirëse i mbeturinave metalike duke përfshirë mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike, automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre.

5.3.2. Përpunimi ose përpunimi i përzier dhe deponimi i mbeturinave jo të rrezikshme me një kapacitet që tejkalon 75 ton në ditë që përfshijnë një ose më shumë nga veprimtaritë e mëposhtëm dhe duke përjashtuar veprimtaritë në lidhje me trajtimin e ujërave të zeza urbane:

5.3.2.1. trajtimi biologjik;

5.3.2.2. para-trajtimi i mbeturinave për djegie ose bashkë-djegia;

5.3.2.3. trajtimi i llumit dhe hirit;

5.3.2.4. trajtimi në grirëse të mbeturinave metalike, duke përfshirë mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre.

Kur veprimtaria e përpunimit të mbeturinave kryhet me tretje anaerobe, kapaciteti i pragut për

ketë veprimtari është 100 ton në ditë.

5.4. Deponitë që pranojnë më shumë se 10 ton mbeturina në ditë ose me një kapacitet total që tejkalon 25 000 ton, duke përfshirë deponitë e mbeturinave inerte.

5.5. Deponimi i përkohshëm i mbeturinave të rrezikshme i cili nuk mbulohet sipas pikës 5.4 në pritje të ndonjë nga veprimtaritë e llastuara në pikat 5.1, 5.2, 5.4 dhe 5.6 me një kapacitet total që tejkalon 50 ton, përveç deponimit të përkohshëm, në pritje të grumbullimit në vendin ku mbeturinat gjenërohen.

5.6. Magazinimi nëntokësor i mbeturinave të rrezikshme me një kapacitet total që tejkalon 50 ton

6. Aktivitetet e tjera

6.1. Prodhimi në impiantet industriale:

6.1.1. Pulpë nga druri ose materiale të tjera fibroze;

6.1.2. Letër apo karton me një kapacitet prodhues që tejkalon 20 ton në ditë;

6.1.3. Një ose më shumë prej paneleve me bazë druri: paneleve të ndryshme me grimca ose me fibra me kapacitet të prodhimit që tejkalon 600 m³ në ditë.

6.2. Para-përpunimi (operacione të tilla si larja, zbardhja, mercerizimi) ose ngjyrosjen e fibrave tekstile apo tekstileve, ku kapaciteti i perpunimit tejkalon 10 ton në ditë.

6.3. Përpunimi e gëzofit dhe lëkurës ku kapaciteti i trajtimit tejkalon 12 ton produkte të gatshme në ditë

6.4. (a) Thertoret operuese me një kapacitet të prodhimit të mishit më shumë se 50 ton në ditë

(b) përpunimi dhe procesimi, përveç paketimit të vetëm, të lëndëve të para në vijim, qoftë i procesuar ose i paprocesuar, të destinuara për prodhimin e ushqimit ose ushqimit për kafshë:

6.4.1. vetëm materiale të papërpunuara të kafshëve (përveç qumështit) me një kapacitet përfundimtar të prodhimit më të madh se 75 ton në ditë;

6.4.2. vetëm materiale të papërpunuara nga perimet me një kapacitet përfundimtar të prodhimit më të madh se 300 ton në ditë ose 600 ton në ditë, ku instalimi vepron për një periudhë jo më shumë se 90 ditë të njëpasnjëshme në çdo vit;


6.4.3. materialet e papërpunuara të kafshëve dhe perimeve, si në produktet e kombinuara dhe të veçanta, si në produktet e kombinuara dhe të veçanta, me një kapacitet përfundimtar të prodhimit në ton në ditë më i madh se:

- 75 në qoftë se A është e barabartë me 10 ose më shumë; ose,
- $[300 - (22,5 \times A)]$ në çdo rast tjetër,

ku 'A' është pjesa e materialit të kafshëve (në përqindje të peshës) të kapacitetit të prodhimit final.

Paketimi nuk do të përfshihet në peshën finale të produktit

Ky nënseksion nuk zbatohet kur lëndë e parë është vetëm qumështi



c) Trajtimi dhe përpunimi vetëm për qumësht, sasia e qumështit të përfituar që është më i madhe se 200 ton në ditë (vlera mesatare mbi bazë vjetore)

6.5. Hedhja ose riciklimi i trupave të kafshëve apo mbeturinave të kafshëve me një kapacitet trajtimi që tejkalon 10 ton në ditë

6.6. Rritja intensive të shpezëve dhe derrave:

6.6.1. me më shumë se 40 000 krerë shpezë;

6.6.2. me më shumë se 2 000 krerë për prodhimin e derrave (mbi 30 kg), ose

6.6.3. me më shumë se 750 krerë për dosa.

6.7. Trajtimi sipërfaqësor i substancave, objekteve ose produkteve që përdorin tretës organik, në veçanti për veshje, printim, veshje, largues të yndyrave, hidroizolues, matjes, ngjyrosjes, pastrim ose mbarsje, me një kapacitet të konsumit tretës organik prej më shumë se 150 kg në orë ose më shumë se 200 ton në vit.

6.8. Prodhimi i karbonit (djegia e plote qymyrit) ose elektrografitit përmes djegies ose grafitizimit.

6.9. Kapja e rrjedhave të CO₂ nga instalimet të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për Kapjen dhe Depozitimin e dioksidit të karbonit në formacione të përshtatshme gjeologjike.

6.10. Ruajtja e drurit dhe produkteve të drurit me kimikate, me një kapacitet prodhues që tejkalon 75 m³ në ditë përveç trajtimit kundër njollave.

6.11. Trajtimi i operuar në mënyrë të pavarur i ujërave të zeza që shkarkohet nga një instalim i përcaktuar me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi.

7. Aktivitetet e minierave

1. Nxjerrja nëntokësore e burimeve minerale me një kapacitet nxjerrjeje që tejkalon njëqindmijë (100.000) ton në vit;

2. Nxjerrja sipërfaqësore e burimeve minerale në një vendndodhje që tejkalon njëzetepesë (25) hektarë.

SHTOCJA 2

LISTA E SUBSTANCAVE NDOTËSE

AJRI

1. Dioksidi i sulfurit dhe përbërësit e sulfurit.
2. Oksidet e azotit dhe përbërësit e tjerë të azotit.
3. Monoksidi i karbonit.
4. Komponimet organike të avullueshme .
5. Metalet dhe komponimet e tyre.
6. Pluhuri përfshirë grimcat e imëta.
7. Azbesti (grimca e suspenduara, fibra).
8. Klori dhe komponimet e tij.
9. Fluori dhe komponimet e tij.
10. Arseniku dhe komponimet e tij.
11. Cianidet.
12. Substancat dhe përzierjet që janë vërtetuar që posedojnë veti kancerogjene ose mutagjene ose elemente të cilat mund të ndikojnë në riprodhim përmes ajrit.
13. Dy-benzo-dioksinet poliklorinike dhe dibenzofuranet poliklorinike.

UJI

1. Komponimet e organo-halogjenit dhe substancave të cilat mund të krijojnë kompozime të tilla në mjedisin ujor.
2. Komponimet organo-fosforike.
3. Komponimet e organike.
4. Substancat dhe përzierjet që janë vërtetuar që posedojnë veti kancerogjene ose mutagjene ose elemente të cilat mund të ndikojnë në riprodhim përmes ajrit.
5. Hidrokarburet e përhershme dhe substancat organike toksike bio-akumuluese.
6. Cianidet

7. Metalet dhe komponimet e tyre
8. Arseniku dhe komponimet e tij
9. Biocidet dhe produktet për mbrojtjen e bimëve
10. Materiet në suspension
11. Substancat që kontribuojnë në eutrofikim (në veçanti, nitratet dhe fosfatet)
12. Substancat që kanë ndikim të pafavorshëm në balancën e oksigjenit (dhe mund të maten duke përdorur parametrat siç janë SHBO (BOD), SHKO (COD), etj.)
13. Substancat e listuara sipas legjislacionit perkates për ujëra.

SHTOCJA 3

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E TMD-SË

1. Përdorimi i teknologjisë me pak mbeturina.
2. Përdorimi i substancave më pak të rrezikshme.
3. Përpunimi i mëtejshëm dhe riciklimi i substancave të përpunuara dhe sipas rastit përdorimi tyre në proces.
4. Proceset e krahasueshme, pajisjet ose metodat e operimit të cilat janë provuar me sukses në shkallë industriale.
5. Përparimet teknologjike dhe ndryshimet në njohuritë dhe kuptimet shkencore.
6. Natyra, efektet dhe vëllimi i emisioneve.
7. Datat e komisionit për impiantet e reja ose ekzistuese.
8. Koha e nevojshme për prezantimin e TMD.
9. Konsumi dhe lloji i lëndëve të para (përfshirë ujin) të përdorura në proces dhe efikasitetin e energjisë.
10. Nevoja për të parandaluar ose zvogëluar në minimum ndikimin e përgjithshëm të emisioneve në mjedis dhe rreziqet ndaj tij.
11. Nevoja për të parandaluar aksidentet dhe minimizuar pasojat për mjedisin.
12. Informacioni i publikuar nga organizata ndërkombëtare publike.

SHTOCJA 4

PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE

1. Publiku informohet (përmes njoftimeve publike ose mjeteve të tjera të përshtatshme të tilla si media elektronike, kur janë në dispozicion) me çështjet e fillimit të procedurës për marrjen e vendimit që informacioni mund të ofrohet:

1.1. aplikimi për një leje ose siç mund të jetë rasti propozimi për përditësimin e lejes apo të kushteve të lejes në përputhje me nenin 8 dhe nenit 20 të këtij ligji.

1.2. kur është e zbatueshme, fakti që një vendim i ndikimit në mjedis është subjekt i një vlerësimi kombëtar ose ndërkuftar ose për konsultimet midis shteteve në përputhje me nenin 28;

1.3. Detajet e autoriteteve kompetente përgjegjëse për marrjen e vendimit, ato nga të cilat mund të merren informatat përkatëse, ato tek të cilat mund të dorëzohen komente ose pyetje dhe detajet e planit kohor për transmetimin e komenteve ose pyetjeve

1.4. natyra e vendimeve të mundshme ose kur ka një draft -vendim;

1.5. kur është e zbatueshme, detajet në lidhje me një propozim për përditësimin e lejes apo të kushteve të lejes;

1.6. koha dhe vendi i mbajtjes së debatit publik si dhe informimi i publikut.

1.7. detajet e marrëveshjeve për pjesëmarrjen e publikut dhe konsultimit të bërë sipas pikës 5 të kësaj Shtojce.

2. Ministria duhet të siguroj që brenda afatit të duhur është në dispozicion për publikun e interesuar

2.1. në përputhje me legjislacionin kombëtar, raportet kryesore dhe këshillat e lëshuara tek autoritetet kompetente ose autoritetet në kohën kur publiku i interesuar ishin informuar në përputhje me pikën 1 të kësaj shtojce mbi qasjen e publikut në informacionin mjedisor

2.2. në përputhje me Udhëzim Administrativ për informim, pjesëmarrje të publikut dhe palëve të interesuara në procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

3. Publiku i interesuar ka të drejtë të shpreh komentet dhe opinionet për Ministrinë para se të merret një vendim.

4. Rezultatet e konsultimeve të mbajtura në përputhje me këtë shtojcë duhet të merren parasysh gjatë marrjes së një vendimi.

5. Aranzhimet e detajuara për informimin e publikut (për shembull me anë të postimit ose publikimit në gazetën lokale) dhe konsultimit me publikun e interesuar (për shembull nga parashtresat me shkrim ose me anë të një hetimi publik) do të përcaktohen nga Ministria. Afatet e arsyeshme kohore për fazat e ndryshme duhet të sigurohen duke lejuar kohë të mjaftueshme për të informuar publikun dhe publiku i interesuar të merr pjesë në mënyrë efektive në vendimarrjet mjedisore që janë subjekt i kësaj Shtojce.

